



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2024:009649

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05485693

**CN.nr.77/24**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevcu - kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Naime Ahmeti, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit M.K nga F.K dhe J.G nga F.K, me objekt kontesti zgjidhja e martesës, besim i fëmijëve dhe caktim i kontaktit, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës së lindur në mes Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13.03.2024, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, **CAKTOHET** si kompetente në pikëpamje territoriale për gjykimin dhe vendosjen e kësaj çështje juridike.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Fushë Kosovë, me aktvendimin C.nr.394/24 të datës 01.03.2024, ka vendosur si në vijim: *“I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë, dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Gllogoc, për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore. II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë”*.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, me aktvendimin C.nr.59/2024 të datës 17.01.2024, shpallet inkompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur në këtë kontest. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat e lëndës së kësaj gjykate, ti dërgohen Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushe Kosovë, si gjykate kompetente në pikëpamje territoriale.

Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit në fjalë, dhe pranimit të lëndës, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë, Gjykatës së Apelit, i ka ushtruar propozim për vendosje lidhur me konfliktin e kompetencës së lindur në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushe Kosove, ngase, konsideron se Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, bazuar në nenin 22 par.1 të LPK-së, nuk mund të shpallet inkompetente në pikëpamje territoriale.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës më të lartë se dy gjykatat në mes të cilave ka lindur konflikti lidhur me kompetencën territoriale, në kuptim të nenit 24 të LPK-së. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoj se Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Fushë Kosovë, me aktvendimin C.nr.394/24 datë 01.03.2024, ka hapur konflikt kompetencën territoriale në raport me Gjykatën Themelore ne Prishtinë Dega ne Glllogoc, e cila është shpallë inkompetente në pikëpamje territoriale. Kështu që, në mbështetje të neneve 17, 37, 38, 44 te LKP-se dhe sipas nenit 72 te Ligjit për Familje (LF), ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit, dhe meqenëse palët nuk kanë parashtruar ankesë, aktvendimi në fjalë është bërë i plotfuqishëm, dhe lënda i është dërguar për kompetencë të mëtutjeshme Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë.

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushe Kosove, pas pranimit të lëndës, në afat prej 3 ditësh sipas nenit 24 të LPK-së, përkatësisht gjyqtari i çështjes ka hap konfliktin për kompetencë në Gjykatën e Apelit, me arsyet e prezantuara si në aktvendim.

Gjykata e Apelit, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, gjeti se Gjykata Themelore në Prishtine Dega në Glllogoc, në kundërshtim me nenin 22 par.1 dhe 2 të LPK-së, është shpallë inkompetente në pikëpamje territoriale. Prandaj, në rastin konkret, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtine Dega ne Glllogoc, duhet të vazhdojë procedurën kontestimore.

Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Glllogoc, tani në këtë fazë të procedurës nuk mund të shpallet in kompetente në pikëpamje territoriale referuar nenit 392 pika (a), ngase neni 22 par.1 në raport me nenin 392 pika (a), të LPK-së, është nen special dhe i aplikueshëm me rastin e kompetencës territoriale dhe se nuk mund të aplikohet neni 392 pika (a) për shpalljen ex officio inkompetente në pikëpamje territoriale, në rastet e kompetencës së përgjithshme dhe asaj të zgjedhur, që në këtë rast ndërgjyqësit e kanë zgjedhur Gjykatën e Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, për ta zgjidhur çështjen lëndore të tyre në të cilën komunë edhe e kishin lidhur martesën, me përjashtim të kompetencës territoriale ekskluzive dhe meqenëse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kompetencë ekskluzive, mbi bazën e të gjitha arsyeve të lartë përmendura, gjykata e shkallës së dytë, në kuptim të nenit 25 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CN.nr.77/24 me datë 13.03.2024**

**Kryetari i Kolegjit**  
Adnan Konushevc